



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**  
**Komuna e Novobërdës**  
**Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo**

**KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY**

**Anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa**  
Z/znj \_\_\_\_\_

Në bazë të dispozitave të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë të dispozitave të nenit 41 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

**F T O J**

Mbledhjen e tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa e cila do të mbahet më 20.04.2022 ( e mërkurë) duke filluar ne ora 10:00.


**R e n d i i d i t ë s**

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së;
2. Raporti tremujor financiar Janar - Mars 2022;
3. Bartja e mjeteve nga të hyrave vetanake të vitit 2021;
4. Pruarja e vendimit për ratifikimin e marrëveshjes së bashkpunimit në mes të Komunës dhe Hidromoraves;
5. Anulimi i vendimit i aprovuar me 27.12.2018 me nr.protokoli 01-7 të datës 10.01.2019, "Kryetari i Komunës të mos ndaj subvencione pa vendim të Kuvendit";
6. Informimi nga komisioni për emërimin e rrugëve;
7. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet në hapësirat e K.K-së në Novobërdë.

Më:15.04.2022  
Në: Novobërdë

**Kryesuese e Kuvendit**  
**Mirjana Simijonovic**



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosova  
**Komuna e Novobërdës**  
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

**KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY**

Nga mbledhja e dytë e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 23.03.2022, duke filluar në orën 10:00. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja e Kuvendit Mirjana Simijonović, Anëtarët e KPF-së: Pranvera Kastrati Gashi, Negovan Jovanović, Abdyl Gashi, Dragana Dimic, Drejtori i Financave z.Milosh Denic, Drejtori i Bujqësisë Slllobodan Savic, Menaxheri i Kompanis EccoHigiena Naser Ibrahim, përfaqësuesi i OSBE-së Edmond Hyseni.

Kryesuesja pasi përshëndeti të pranishmit tha: Para se të fillojmë me rendin e ditës duhet konstatuar kuorumin prezentë janë të gjithë antarët e KPF-së, konstaton se ka kuorum për punë dhe filloj mbledhjen me këtë:

**R e n d d i t e**

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;
2. Ndryshimet e mjeteve të caktuara buxhetore transferet dhe subvencionet për dhënjen e ndihmes momentale për njerëzit me nevoj;
3. Shqyrtimi i draft rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkpunimin e Komunës me Fshatrat, vendbaimet dhe lagjet urbane;
4. Raporti i punës nga Kompania EcoHigiena;
5. Të ndryshme;

Kryesuesja i pyeti të pranishmit se a pajtohen me këtë rend dite apo keni ndonjë propozim?.

Drejtori i Bujqësisë Slllobodan Savic pasi përshëndeti të pranishmit tha: kerkoj falje që me kohë se kam derguar kërkesen që të kyçet edhe kjo pikë në rend dite, bëhet fjalë për dhënjen e teritorit të Komunës për vendgjahishte.

Kryesuesja tha: duke pas parasysh se Drejtori i Bujqësisë e propozoj këtë pikë për rend dite a jeni përë atë që të kyçet kjo pikë për rend dite?.

Aprovohet njëzëri propozimi nga Slllobodan Savic që të futet në rend dite.

**Pika e parë:** Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati vërejtje aprovohet njëzëri procesverbali nga mbledhja e kaluar nga anëtarët prezent të KPF-së.

**Pika e dytë:** Ndryshimet e mjeteve të caktuara buxhetore transferet dhe subvencionet për dhënjen e ndihmes momentale për njerëzit me nevoj;

Kryesuesja për këtë pikë ja dha fjalën Drejtorit të Financave zt.Milos Denic.

Milos Denic pasi përshëndeti të pranishmit tha: gjatë pregaditjes së buxhetit që ta plotësojm grandin nga viti i kaluar, këtë shumën prej 11,000€ e kemi bartur në grandin e Drejtorisë së Arsimit në sektorin e Subvencioneve, pra qëllimi ka qenë që këto mjete mos ti humbin në vitin e kaluar, ndërsa këtë vit në mënyrë

që ti shfrytëzojm këto mjete pra mos ti humbin na duhet një vendim i Kuvendit Komunal në mënyrë që ti shfrytëzojm këto mjete spas rregullores së brendshme që e kemi për ndihmë njerëzve në nevoj, ju faleminderit.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pranvera Kastrati Gashi pasi pershendeti të pranishmit tha: paraprakisht duhet të caktohet vlera mjeteve buxhetore, të bëhet njoftimi publik në Komuna në mënyrë që të informohen të gjithë të sëmuret, të caktohen kriteret e domosdoshme dhe afati i publikimit. Ne nuk jemi të informuar që ka kërkesa nga qytetarët në nevojë, nuk i përkrahim kërkesat që kanë kërkuar përmes rrugëve pasi që dihet se Komuna jonë ka shumë njerëz me nevojë andaj duhet tju dhëjmë mundësin që të aplikojnë të gjithë.

Milos Denic tha: shumen e keni para vetit 11,800€, në anen tjetër e kemi rregulloren e brendshme të Komunës ku në bazë të sajna i ndajmë ndihma për njerëzit në nevojë.

Pranvera Kastrati Gashi tha: duhet të bëhet publik afati i aplikimit në mënyrë që të gjithë të aplikojnë.

Milos Denic tha: në bazë të rregullores që e kemi nuk ceket se duhet të publikohet.

Kryesuesja tha: besoj se në Kuvend do ta shqyrtojmë më gjerësishtë, këtu jemi vetem se a duhet të dergohet kjo pikë apo jo.

Pasi nuk pati diskutime tjera me 4 vota për, 1 kunder (Pranvera Kastrati Gashi) aprovohet kjo pikë që të shkoj në Kuvend nga antarët prezent të KPF-së.

**Pika e tretë:** Shqyrtimi i draft rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkpunimin e Komunës me Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane;

Kryesuesja tha: besoj se draftin e propozuar e keni marrë përmes e-mailit, në Kuvend do të vij dikush nga ekzekutivi që të prezantoj këtë pikë, propozoj që të dergohet në Kuvend e pastaj atje të diskutohet.

Aprovohet njëzëri kjo pikë që të shkoj në Kuvend nga antarët prezent të KPF-së.

**Pika e katërt:** Raporti i punës nga Kompania EcoHigiena;

Për këtë pikë ja dha fjalën Menaxherit të kompanisë EccoHigiena Naser Ibrahimit.

Naser Ibrahimit pasi pershendeti të pranishmit tha: ne punojm 5 ditë në javë të plota, i kemi të ndara fshatrat se cilen ditë punojmë të hënë, cilen të martën e kështu me radhë. Ne operojmë me dy kamion deri në vitin 2019, pastaj kemi mbet me një kamion, ne vitin 2020 kemi mbet pa asnjë andaj ne kemi huazuar në kamion nga Ecohigiena në Gjilanë dhe me atë kamion jemi duke mbuluar të gjithë teritorin e Komunës. Ne i kemi 1506 ekonomi familjare që faturohen çdo muaj, biznese janë 104, 735 janë ekonomi familjare pasive si raste sociale dhe veteranët e luftës. Me gjersishtë do të informoheni ne Kuvend, nese keni ndonjë pyetje urdhëroni.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime aprovohet njëzëri kjo pikë që të shkoj në Kuvend.

**Pika e pestë:** Prerja e vendimit për dhënjën e Pajtueshmerisë për dhënjën e vendgjahishtës në teritorin e Komunës së Novobërdës;

Për këtë pikë Kryesuesja ja dha fjalën Drejtorit të Bujqësisë Sllobodan Savic.

Sllobodan Savic tha: do të mundohem të sqaroj se çka konkretishtë po kërkojmë, kemi që një kohë të gjatë problem me qytetarët e në anen tjetër e kemi një vlerësim të inspeksionit për pylltari të viti 2017, ku inspeksioni na ka ndaluar aktivitetin e gjuetis në Komunën e Novobërdës deri sa mos të zgjidhet problemi i vendgjahishtës, deri sa mos të caktohet zona se ku munden gjuetarët me vepru. E kemi edhe vendimin e Drejtorëve të mëhershëm, drejtorit të inspeksionit që e ka ndaluar gjuetinë, mirëpo fatkeqësishtë kem gjuetar të pandergjegjshëm që dalin dhe gjuajnë, nga Ministria e Bujqësisë e kemi pajtueshmerinë që ta caktojm vendgjahishten në teritorin e Komunës, por nuk mundemi ta shpallim tenderin publik, nuk mundë të veprojm pa e pasur edhe pajtueshmerin nga Kuvendi.

Kryesuesja tha: e dimi se si ka funksionuar Kuvendi Komunal në mandatin e kaluar, fatkeqësishtë për arsye të ati mosbashkpunimi në Kuvend as nuk ka pasur kërkesë as skemi pasur mundësi të biem pajtueshmeri, andaj është shumë e rëndësishme që ashtu si këshilli ekzekutivi dhe ai ligjvënës të kemi bashkpunim të ngushtë në mes veti, po më vjen mirë që po e respektoni Kuvendin, besoj se deri në mbledhje të Kuvendit do ta siguron materialin edhe në gjuhen serbe.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Abdyl Gashi pasi pershendeti të pranishmit tha: vetem kërkoj të dij se sa km<sup>2</sup> kërkojn të dhëjnë në shfrytëzim, a do të ndertohet aty diçka apo vetem do të shfrytëzohet për vendgjetim, duhet me qenë më e specifikuar.

Kryesuesja tha: shpresoj se këto informata do të kemi të gjitha në Kuvend.

Sllobodan Savic tha: në aplikacionin që kemi aplikuar në Ministri, janë të gjitha shenimet, është edhe harta se ku janë të parapara këto vendgjahishte dhe atë material do ta dergojmë.

Pasi nuk pati diskutime tjera aprovohet njëzëri kjo pikë që të shkoj në Kuvend.

**Pika e gjashtë:** të ndryshme;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Abdyl Gashi tha: vetem kërkoj që të konsultoheni edhe me komitetin për komunitete, në mandatin e kaluar kam qenë edhe unë aty dhe ata kanë mundësi që të shtyn shumë qështje, shumë pika që të vin drejt në Kuvend, dhe mos ta anashkalojm si komitet pasi që edhe ai është shumë i rëndësishëm.

Kryesuesja tha: këtë muaj e kemi kompletuar atë komitet, dhe mbledhjen e parë e kam thirr unë, e kemi zgjedhur Kryesuesen dhe zv.Kryesuesin, i kam uruar për pozitën dhe i kam njoftuar se dyert e Kuvendit janë të hapur për komitet.

Pasi përfundimit të diskutimit Kryesuesja i falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:45.

Procesmbajtëse  
Valmire Mustafa



Kryesuesja Kuvendit  
Mirjana Simijonović





**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosova  
**Komuna e Novobërdës**  
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



**KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY**

Në bazë të Rregullores për Subvencione me nr. 01/2096 të datës 14.11.2012, neni 6 Kuvendi Komunal i Komunës së Novobërdës me datë **27.12.2018** merrë këtë:

**V E N D I M**

**Q Ë**

**KRYETARIT TË KOMUNËS TË MOS KRYEJ NDARJEN E SUBVENCIONEVE PA  
VENDIM TË KUVENDIT**

- I. **APROVOHET** vendimi që Kryetari i Komunës nga kjo seanc nuk ka të drejt të ndaj subvencione pa vendim të Kuvendit.
- II. Ky vendim mirret për arsye të mos raportimit të Kryetarit në Kuvendin Komunal për ndarje të Subvencioneve.
- III. Vendimi hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në ëeb faqe të Komunës.

Më 10.01.2019  
Në Novobërdë



Nebojsa Arsic  
Kryesues i Kuvendit

*Nebojsa Arsic*

# MARRËVESHJE E SHËRBIMIT

---

në mes të

**KOMPANISË RAJONALE TË UJËSJELLËSIT**

**“HIDROMORAVA”-SH.A. -GJILAN**

dhe

**KOMUNËS NOVO BËRD**

Nëntor 2022

Kjo MARRËVESHJE E SHËRBIMIT ("Marrëveshje") është bërë më datë 31.03.2022 në mes të Komunës Novo Bërd dhe Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Hidromorava"-sha në bazë të Ligjit mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimit të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe të Mbeturinave (Ligji Nr. 03/L-086").

Komuna dhe KRU në tekstin e mëtuftjeshëm referohen bashkarisht si "Palët" dhe ndarazi si "Pala".

### PJESA HYRËSE

Në pajtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, Republika e Kosovës është pronare e KRU-së (neni 5), ndërkaq me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale është përcaktuar që midis kompetencave tjera të Komunave të përfshihet edhe ofrimi i shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit përsa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm (neni 17.1 (f)). Në anën tjetër, me Ligjin Nr.03/L-086, është themeluar Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim ("ZRRUK") si autoritet i pavarur rregullator që rregullon veprimtarinë e ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit në Kosovë. Me këtë Ligj është përcaktuar që KRU-të duhet të nënshkruajnë Marrëveshjen e Shërbimit me Komunitat të cilat shtrihen brenda Zonës së tyre të Shërbimit (neni 6.2. (e)).

DUKE PASUR PARASYSH SE, KRU-ja është pronare e aseteve që shërbejnë për ujësjellës dhe për ofrimin e shërbimeve të kanalizimit dhe rrjedhimisht përgjegjëse për operimin, mirëmbajtjen, përtëritjen dhe zgjerimin e këtyre aseteve.

DUKE PASUR PARASYSH SE, me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Komuna është organ kompetent në ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë ujësjellësin dhe kanalizimin në territorin e saj.

DUKE PASUR PARASYSH SE, Komuna dhe KRU janë marrë vesh të arrijnë objektivat vijuese:

- (a) Të promovojnë fuqizimin menaxherial dhe operacional të KRU-së;
- (b) Të sigurojnë që KRU-ja të arrijë të krijojë dhe të mbajë kapacitetet financiare në nivelin e duhur që i mundëson asaj të gjenerojë të hyra të mjaftueshme për mbulimin e plotë të kostove me qëllim që të mirëmbajë dhe operojë objektet dhe pajisjet për ofrimin e shërbimeve adekuate për popullatën e Komunës;
- (c) Të promovojnë implementimin e programeve investuese efektive në aspektin e kostove me theks në përmirësimin e efijencës së sistemeve ekzistuese;
- (d) Të sigurojë që KRU të bashkëpunojë me Komunitat gjatë hartimit të planeve zhvillimore aty ku planifikohet zgjerim i zonës së shërbimeve me ujësjellës dhe kanalizim.

DUKE PASUR PARASYSH SE, kjo MARRËVESHJE ka për qëllim të përshkruajë të drejtat dhe obligimet e KRU-së lidhur me operimin e aseteve të sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit që i shërbejnë Komunës, dhe që të përshkruajë të drejtat dhe obligimet e Komunës në ofrimin e ndihmës për KRU-në në arrijten e objektivave të saj.

Komuna dhe KRU pajtohen si vijon:

## NENI 1 PËRKUFIZIMET

Për qëllimet e kësaj MARRËVESHJE, fjalët dhe termet në vazhdim do ta kenë kuptimin si vijon:

- “Autorizimi”** nënkupton të drejtën ekskluzive të cilën Komuna ia jep KRU-së për ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit në territorin e Komunës;
- “Data Efektive”** nënkupton datën e hyrjes në fuqi të kësaj MARRËVESHJEJE;
- “Kërkesa Ligjore”** nënkupton të gjitha ligjet, aktet nënligjore, urdhëresat, licencat, lejet, dhe rregullat në fuqi të nxjerra nga institucionet kompetente që kanë juridiksion mbi çështjen në fjalë;
- “Kohëzgjatja”** nënkupton afatin e aplikueshmërisë së kësaj MARRËVESHJEJE;
- “Komisioni Këshillues i Konsumatorëve”** nënkupton komisionin e themeluar për Zonën e Shërbimit të KRU-së në pajtim me Ligjin për Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe Mbeturinave;
- “NJPM të NP”** nënkupton Njësinë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike e themeluar me Ligjin për Ndërmarrjet Publike;
- “Rregulatori”** nënkupton Zyrën Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim që në këtë dokument referohet edhe si ZRRUK;
- “Shërbimet e Kanalizimit”** nënkupton grumbullimin, trajtimin dhe shkarkimin e ujërave të zeza;
- “Shërbimet e Ujësjellësit”** nënkupton marrjen, trajtimin dhe distribuimin e ujit për konsum njerëzor si dhe operimin e rrjetit dhe objekteve që përdoren për këtë qëllim;
- “Standardet e Shërbimit”** nënkupton secilin standard të aplikueshëm për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit të përcaktuara në pajtim me Ligjin për Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe të Mbeturinave;
- “Tarifat e Shërbimit”** nënkupton çdo ngarkesë apo tarifë e cila shfrytëzohet nga KRU-ja për faturimin e shërbimeve të Ujësjellësit dhe Kanalizimit ;
- “Zona e Shërbimit”** nënkupton komunat në të cilat KRU-ja ofron shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit;

## NENI 2 DHËNIA E SË DREJTËS EKSKLUZIVE

### 2.1 Autorizimi

Me këtë MARRËVESHJE komuna i jep autorizimin KRU-së sipas të cilit, KRU-ja ka të drejtën ekskluzive që gjatë afatit të kësaj MARRËVESHJEJE të ofrojë Shërbimet e Ujësjellësit dhe Shërbimet e Kanalizimit, në mënyrë që, asgjë nga kjo MARRËVESHJE nuk do të ndalojë personat në Komunë që të kenë në pronësi dhe të operojnë me objektet të cilat shërbejnë për përmbushjen e nevojave të tyre për ujë të pijes (vet-furnizues);

### 2.2 Parimet udhëheqëse të kësaj MARRËVESHJEJE

Komuna dhe KRU-ja pajtohen që aftësia për të përmirësuar kualitetin e Shërbimeve të Ujësjellësit dhe të Kanalizimit varet mbi:

- (a) pavarësinë financiare dhe operative të KRU-së si një ndërmarrje me orientim komercial, e afërt me konsumatorët dhe financiarisht e vetë-qëndrueshme;

- (b) zbatimin e rregullave, rregulloreve, udhëzimeve dhe vendimeve të Rregullatorit dhe autoriteteve tjera që kanë kompetenca në bazë të ligjit në fusha të caktuara të veprimtarisë së KRU-së duke përfshirë përcaktimin e tarifave që reflektojnë mbulimin e kostove;
- (c) rritjen e vetëdijes mbi rëndësinë e shërbimeve publike dhe orientimin në ofrimin e shërbimeve sipas kësaj MARRËVESHJEJE;
- (d) ngritjen e efikasitetit operative të KRU-së;
- (e) marrja e vendimeve kost-efektive për investimet e nevojshme në sistemet e ujësjellësit dhe të kanalizimit me qëllim të ruajtjes së bazës ekzistuese të aseteve dhe zgjerimit të tyre;
- (f) puna e përbashkët dhe bashkëpunimi i Palëve për arritjen e objektivave të tyre.

### 2.3 Rregullimi i Shërbimeve të Ujësjellësit dhe të Kanalizimit

Palët e kuptojnë se rregullimi i veprimtarisë së KRU-së është subjekt i *Ligjit për Rregullimin e Veprimtarisë së Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe Mbeturisë*, dhe Rregullatori është përgjegjës për implementimin e tij. Ofrimi i shërbimeve dhe mirëmbajtjes është subjekt i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, ndërsa çështjet që lidhen me pronësinë, qeverisjen korporative, përgjegjësinë dhe e raportimin janë subjekt i Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe amendamentimeve të bëra këtij ligji. Çfarëdo konflikti ndërmjet kësaj MARRËVESHJEJE dhe këtyre tri ligjeve do të zgjidhet në favor të këtyre ligjeve si dhe ligjeve tjera të aplikueshme në Kosovë.

### 2.4 Obligimet e KRU-së

Dhënia të drejtës ekskluzive nga Komuna tek KRU-ja nënkupton që KRU të operojë në pajtim me kornizën rregullatore në fuqi si dhe në pajtim me ligjet e aplikueshme, duke pasur parasysh si në vijim:

- (a) KRU-ja duhet të operojë me objektet dhe pajisjet e saj që i shfrytëzon për ofrimin e shërbimeve në pajtim me praktikën e mira për shërbimet publike. KRU-ja duhet të ofrojë shërbime të sigurta, të cilësisë së duhur dhe pa diskriminime në asnjë aspekt, dhe poashtu të bëjë përmirësimet, zgjerimet dhe ngritjen e kapaciteteve në përputhje me rritjen e konsumatorëve sipas nevojës;
- (b) KRU-ja duhet të bëjë të gjitha përpjekjet e duhura që të krijojë mundësi për ofrimin e shërbimeve të sigurta dhe të vazhdueshme për të gjithë konsumatorët konform situatave;
- (c) KRU-ja duhet të ofrojë shërbimet sipas kësaj MARRËVESHJEJE në mënyrë efektive dhe efikase, në përputhje me Standardet e Shërbimit të përcaktuara nga Rregullatori (ZRRUK) dhe organet tjera ligjore;
- (d) KRU-ja duhet të hartojë dhe zbatojë politikën dhe procedurat operative të shkruara për ofrimin e shërbimeve sipas kësaj MARRËVESHJEJE, duke përfshirë politikën dhe procedurat për veprim në situatë emergjente, dhe zgjidhjen e ankesave si dhe kërkesave të konsumatorëve. Kur është e aplikueshme politikën dhe procedurat e tilla duhet të jenë në përputhje me kërkesat minimale të përcaktuara me ligjet, rregulloret dhe politikën qeveritare;
- (e) KRU-ja duhet të hartojë programin e investimeve kapitale duke marrë informacione të duhura nga Komuna, për sa i përket investimeve në territorin e saj;
- (f) KRU-ja duhet të propozojë tarifën për aprovim nga Rregullatori në pajtim me rregullat dhe metodologjinë në fuqi;
- (g) KRU-ja duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme dhe të arsyeshme, duke përfshirë reduktimin ose ndërprerjen e shërbimeve për konsumatorët, kur kjo është e nevojshme për të mbledhur borxhet e konsumatorëve;

- (h) KRU-ja duhet që raportet e rregullta për NJPM-në dhe ZRRUK-in për çështjet financiare, operative dhe të cilësisë së shërbimeve në pajtim me obligimet e përcaktuara në bazë të ligjit, ti dorëzojë edhe në Komunë dhe t'i bëjë publike për konsumatorët gjithashtu;
- (i) KRU-ja duhet të informojë Komunën mbi aktivitetet e saj në formën dhe shpeshtësinë siç mirren vesh Palët;
- (j) KRU-ja duhet të ndër marrë të gjitha vendimet dhe veprimet e duhura në pajtim me ligjet e aplikueshme që janë të nevojshme për përmbushjen e obligimeve të kësaj MARRËVESHJEJE;
- (k) KRU-ja duhet në bashkëpunim me Komunën të merr të gjitha masat e nevojshme në reduktimin e humbjeve të ujit për shkak të kyçjeve jo legale, keqpërdorimit të ujit, etj.;
- (l) KRU-ja duhet të sigurojë faturim të rregullt për të gjithë konsumatorët e regjistruara në sistemin e faturimit dhe kontabilitetit;
- (m) KRU-ja duhet të sigurojë mbledhjen e rregullt të të hyrave;
- (n) KRU-ja duhet të punojë drejt shtimit të numrit të popullsisë të furnizuar me ujë të pijshëm dhe shërbime të kanalizimit, në tërë territorin e Komunës dhe të koordinojë zhvillimin e infrastrukturës me planet e zhvillimit Komunal;
- (o) KRU-ja duhet të bashkëpunojë me Komunën në shpërndarjen e informatave, në ngritjen e vetëdijes dhe edukimin e popullatës në të gjitha aspektet rreth furnizimit me ujë dhe shërbimeve të kanalizimit, duke përfshirë këtu edhe aspektin shëndetësor dhe higjienik, si dhe menaxhimin e burimeve të ujit;

Obligimet e KRU-së sipas kësaj MARRËVESHJEJE përmbushen me kusht që:

- (i) Komuna i përmbush obligimet e saj sipas kësaj MARRËVESHJEJE, dhe
- (ii) Asnjë ligj, rregullore nacionale apo lokale, dekret apo resolutë nuk miratohet që do ta bënte ligjërish të pamundur përmbushjen e obligimeve sipas kësaj MARRËVESHJEJE.

## 2.6 Obligimet e Komunës

- (a) Komuna duhet të paguajë me kohë faturat e KRU-së për shërbimet që i ofrohen Komunës apo institucioneve tjera që financohen prej buxhetit të saj;
- (b) Komuna duhet ti lejojë KRU-së ofrimin e shërbimeve në mënyrë efektive dhe efiçente;
- (c) Komuna duhet ti ofrojë dy herë në vit KRU-së informata relevante për planifikimin, zhvillimin dhe zgjerimin e zonës së Komunës në mënyrë që KRU-ja t'i shqyrtojë ato informata dhe t'i marrë parasysh në planet e saj të investimeve kapitale dhe operative;
- (d) Komuna duhet të shqyrtojë dhe të këshillojë mbi investimet kapitale programet e KRU-së nëse ato ndodhin në territorin e komunës përkatëse në mënyrë që të arrihet koordinim me objektivat e planifikimit komunal;
- (e) Komuna duhet t'i ndihmojë dhe ta mbështesë KRU-në me të gjitha mjetet e duhura në ndërmarrjen e të gjitha masave për arkëtimin e faturave nga konsumatorët për shërbimet e ofruara në pajtim me dispozitat e ligjeve të aplikueshme;

- (f) Komuna duhet të bashkëpunojë me KRU-në në të gjitha format e nevojshme dhe adekuate për t'i mundësuar KRU-së përmbushjen e obligimeve të saj sipas kësaj MARRËVESHJEJE;
- (g) Komuna duhet të propozojë anëtarët për Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve të cilët themelohen dhe funksionojnë në regjionin e Zonës së Shërbimit të KRU-së në pajtim me ligjet e aplikueshme;
- (h) Komuna duhet të ndërmarrë të gjitha vendimet dhe veprimet e duhura në pajtim me ligjet e aplikueshme që janë të nevojshme për përmbushjen e obligimeve të kësaj MARRËVESHJEJE;
- (i) Komuna duhet ta mbështes KRU-në për të zvogëluar humbjet e ujit (lidhjet ilegale, keqpërdorimet e ujit etj);
- (j) Komuna duhet të ndërmerë veprime formale kundër atyre konsumatorëve që nuk i përmbahen rregulloreve komunale dhe të KRU-së;
- (k) Komuna duhet të bashkëpunojë me KRU-në në shpërndarjen e informatave, në ngritjen e vetëdijes dhe edukimin e komunitetit, në të gjitha aspektet e furnizimit me ujë dhe kanalizim, duke përfshirë shëndetin dhe aspektet e higjenes si dhe menaxhimin e burimeve të ujit;
- (l) Komuna duhet të bashkëpunojë me KRU-në dhe ZRRUK-in në zgjidhjen e problemeve, kur kërkohet;
- (m) Komuna duhet të koordinojë resurset në aspektin e shkëmbimit të informatave, financimit dhe ekspertizës kurdo që është e mundur;
- (n) Komuna duhet të kontribuojë në influencimin e politikave nacionale dhe kornizës legjislative;
- (o) Komuna duhet të mbajë takime të rregullta apo mujore me KRU-në;
- (p) Komuna duhet të marrë parasysh mundësinë e sistemit të ujësjellsit për të siguruar sasi të mjaftueshme të ujit, dhe të sigurojë që sistemi i kanalizimit është i madhësisë adekuate për shkarkimin e ujërave të kanalizimit që para ndonjë aprovimi të planit të ri infrastrukturor.

Obligimet e Komunës sipas kësaj MARRËVESHJEJE përmbushen me kusht që:

- (i) KRU-ja i përmbush obligimet e saj sipas kësaj MARRËVESHJEJE, dhe
- (ii) Asnjë ligj, rregullore nacionale apo lokale, dekret apo resolutë nuk miratohet që do të bënte ligjërisht të pamundur përmbushjen e obligimeve sipas kësaj MARRËVESHJEJE.

### NENI 3 LEHTËSIMET

#### 3.1 E Drejta e Shfrytëzimit të Pronës Publike

Për qëllimet e kësaj MARRËVESHJEJE dhe gjatë kohëzgjatjes së saj, KRU-së i jipet e drejta e shfrytëzimit të hapsirës mbi, nën, përgjatë ose në objekte publike, duke përfshirë rrugët, trotualet, autostradat, urat dhe hapësirat e gjelbëruara me qëllim të ndërtimit dhe mirëmbajtjes së tubacioneve nëntokësore, pusetave dhe objekteve të tjera të ngjajshme që mund të jetë e nevojshme dhe e përshtatshme për ofrimin e shërbimeve sipas kësaj MARRËVESHJEJE (që referohet si e "Drejta e Shfrytëzimit të Pronës Publike").

### 3.2 Shfrytëzimi i të Drejtës në Pronën Publike

KRU-ja autorizohet dhe ka të drejtë në shfrytëzimin e pronës publike sipas kësaj MARRËVESHJEJE, me kusht të respektimit të sigurisë publike dhe të restriksioneve shëndetësore të përcaktuara me ligj dhe rregulloreve të Komunës. Poashtu, gjatë kohëzgjatjes së kësaj MARRËVESHJEJE, KRU-ja duhet që në bashkëpunim me organet kompetente të Komunës dhe në pajtim me ligjet dhe normat e aplikueshme të kryejë të gjitha gërmimet nëpër rrugë, trotuare, autostrada dhe sipërfaqe publike në kohën dhe formën e duhur me sa më pak pengesa për shfrytëzimin publik të asaj prone publike në mënyrën më të përshtatshme për rrethant e caktuara. Pas gërmimit, KRU-ja duhet të bëjë përpjekje maksimale për kthimin e asaj prone publike në gjendjen që ka qenë para kryerjes së gërmimit.

## NENI 4

### KËRKESAT LIGJORE DHE NDIHMA NGA KOMUNA

#### 4.1 Kërkesa Ligjore

Komuna nuk do të shkaktojë ose të mbështesë: ndonje ndryshim ligjor brenda fushës dhe kompetencave të komunës, pas arritjes së kësaj MARRËVESHJEJE, e që do të shkelte të drejtat dhe obligimet e Palëve sipas kësaj MARRËVESHJEJE.

#### 4.2 Aplikimi për Përfitime

Palët nuk do të pengohen nga kjo MARRËVESHJE që të aplikojnë për përfitime nga çdo ligj, qoftë ekzistues apo i miratuar pas kësaj date, për të cilin Pala është e kualifikuar.

#### 4.3 Ndihma për Lejet Komunale

Komuna do të bëjë përpjekje të arsyeshme për ta ndihmuar KRU-në për marrjen nga Komuna dhe departamentet e Komunës të autorizimeve, lejeve të ndërtimit, lejeve tjera, pëlqimeve, aprovimeve, certifikatave dhe dokumenteve të tjera dhe do të ndërmerr veprime të duhura sipas nevojës ose në pajtim me ligjin ose rregulloret komunale me qëllim që t'ia lehtësojë KRU-së operimin, mirëmbajtjen dhe zgjerimin e shërbimeve sipas kësaj MARRËVESHJEJE, me kusht që për një gjë të tillë të mos kërkohet që Komuna të bëjë aplikacion ose kërkesë në emër të KRU-së.

#### 4.4 Ndihma për Lejet e Tjera dhe për të Drejtën e Shfrytëzimit

Komuna do të bëjë përpjekje të arsyeshme për ta ndihmuar KRU-në për marrjen e shpejtë të çfarëdo lejeje, pëlqimi dhe të drejtën e shfrytëzimit të pronës private, apo të dokumenteve të tjera ose veprimeve të nevojshme që kërkohen nga cilido organ zyrtar i Kosovës në lidhje me operimin, mirëmbajtjen ose zgjerimin e shërbimeve sipas kësaj MARRËVESHJEJE, me kusht që për një gjë të tillë të mos kërkohet që Komuna të bëjë aplikacion ose kërkesë në emër të KRU-së.

#### 4.5 Ndihma për Kursimin e Ujit

Komuna do të ofrojë ndihmën e vet për zbatimin e udhëzimeve dhe urdhëresave për kursimin e ujit në tërë komunën.

#### 4.6 Ndihma për Arkëtimin e Faturave

Komuna do ti ofrojë KRU-së ndihmën e saj për arkëtimin e faturave me të gjitha mjetet dhe mekanizmat zbatues që ka në dispozicion.

## NENI 5 TARIFAT

### 5.1 Pagesat për Shërbimet e Ujësjellësit dhe Kanalizimit

Tarifat me të cilat KRU-ja faturon për shërbimet e ofruara aprovoen nga Rregullatori dhe KRU-ja është e obliguar që të njëjtat t'i publikojë në mjetet e informimit publik.

### 5.2 Pagesat për Shërbimet Tjera

Për çfarëdo shërbimi që mund të kërkohet nga Komuna e që nuk është përfshirë në listën e tarifave të shërbimit të aprovuara nga Rregullatori, duhet që Komuna dhe KRU-ja të nënshkruajnë kontratë me shkrim duke specifikuar çmimin dhe sasinë dhe vlerën totale të shërbimit.

### 5.3 Tarifat për Fikjen e Zjarrit

Uji i pijes që përdoret nga Njësia e Zjarrëfikësve për shuarjen e zjarrit nuk do të faturohet nga KRU-ja.

### 5.4 Tarifat për Krojet publike

KRU-ja e faturon Komunën për Ujin që shfrytëzohet nga krojet publike.

## NENI 6 NDËRPREJA E SHËRBIMIT PËR KOMUNËN

KRU-ja, në pajtim me dispozitat ligjore do të ndërprejë të gjitha shërbimet e saja për Komunën dhe departamentet e saj nëse faturat nuk paguhen mbrenda afatit kohor që parashihet në ligj.

## NENI 7 MOSPËRMBUSHJA E OBLIGIMEVE DHE DËNIMET

### 7.1 Rastet e Mospërmbushjes së Obligimeve nga Pala

Secila nga sa vijon, do të konsiderohet "Mospërmbushje e Obligimeve" nga Pala e caktuar:

- (a) Nëse Pala ("Pala Mospërmbushëse") dështon të përmbush cilëndo nga dispozitat e kësaj MARRËVESHJEJE ose të ndonjë dispozite të ligjeve, rregulloreve ose urdhërësive të zbatueshme dhe ky dështim pamundëson përmbushjen e obligimeve të kësaj MARRËVESHJEJE dhe një dështim i tillë zgjat për një periudhë prej gjashtëdhjetë (60) ditësh në vazhdimësi, përveç nëse Pala Mospërmbushëse ka filluar veprimet për recuperimin e atij dështimi brenda periudhës prej gjashtëdhjetë (60) ditësh dhe është e përkushtuar që ta recuperojë dështimin.
- (b) Nëse Pala Mospërmbushëse dështon që tri (3) herë brenda periudhës prej gjashtë (6) muajve (pa marrë parasysh recuperimet e dështimeve) të jetë në pajtim me cilëndo dispozitë të kësaj MARRËVESHJEJE pas vërejtjes nga Qeveria e Kosovës ose nga Pala tjetër.

## NENI 8 NDASHMËRIA E KLAUZOLAVE

Të gjitha klauzolat e kësaj MARRËVESHJEJE janë të veçanta dhe të ndara, dhe nëse ndonjë nga këto klauzola konsiderohet e paligjshme, anulohet ose e pazbatueshme, e njëjta nuk do këtë ndikim në validitetin, legalitetin ose zbatueshmërinë e klauzolave tjera.

NENI 9  
LIGJI I APLIKUESHM

Kjo MARRËVESHJE interpretohet dhe qeveriset sipas ligjeve të zbatueshme në Kosovë.

NENI 10  
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Në rast të mosmarrëveshjeve, kontradiktave apo ankesave që mund të dalin nga ose në lidhje me këtë MARRËVESHJE, Palët do të bëjnë përpjekje që të zgjidhin mosmarrëveshjet në mënyrë miqësore.

Kur mosmarrëveshjet nuk mund të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe në baza të vullnetit të mirë, ato do ti nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente në Kosovë.

NENI 11  
NJOFTIMET

Të gjitha njoftimet ndërmjet Palëve do të bëhen me shkrim dhe do të dërgohen përmes postës në adresë:

- (a) Njoftimet që dërgohen nga KRU-ja tek Komuna:

Komuna Novo Bërd  
Kryetari i Komunës: z. Sasha Milosheviq

*Kopje:*

- o *Njësia për Politika dhe Monitorim e Ndërmarrjeve Publike Udhëheqësi i Njesisë.*
- o *Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim Drejtori.*

- (b) Njoftimet që dërgohen nga Komuna tek KRU-ja:

KRU "Hidromorava"- Sh.A -Gjilan  
Kryeshefi Ekzekutiv

*Kopje:*

- o *Njësia për Politika dhe Monitorim e Ndërmarrjeve Publike Udhëheqësi i Njesisë.*
- o *Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim Drejtori.*

NENI 12  
KOHËZGJATJA

- 12.1 Kjo MARRËVESHJE hyn në fuqi pas pranimit teknik të ujesjellesit dhe marrjes së menaxhimit të tyre dhe do të këtë kohëzgjatje fillestare prej katër (4) vitesh prej datës së hyrjes në fuqi ("Afati Fillestar"). Pas skadimit të Afatit Fillestar, MARRËVESHJA përtrihet automatikisht çdo katër (4) vjet, përveç nëse njëra Palë e njofton me shkrim Palën tjetër se ka vendosur të mos e vazhdojë MARRËVESHJEN. Njoftimi në këtë rast duhet të bëhet së paku gjashtë (6) muaj para përfundimit të afatit të skadimit të MARRËVESHJES.

- 12.2 Njoftimi për vendimin e ndërprerjes së kësaj MARRËVESHJEJE, duhet që në afatin e paralajmërimit të përcaktuar në paragrafin 12.1, ti dërgohet NjPM-së të NP-së dhe ZRRUK-it nga Pala që ka vendosur ta ndërpres MARRËVESHJEN, me qëllim që t'i jipet kohë e mjaftueshme Qeverisë dhe ZRRUK-it që në kuadër të përgjegjësive ligjore që kanë të ndërmarrin veprimet e nevojshme për të siguruar që nga kjo ndërprerje e MARRËVESHJES të mos rrezikohet ofrimi i shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit për popullatën e e Komunës dhe që zgjidhja alternative që bëhet pas ndërprerjes së kësaj MARRËVESHJEJE të jetë në pajtim me politikat dhe ligjet e aplikueshme në lidhje me shërbimet e ujësjellësit dhe të kanalizimit.

NENI 13  
MODIFIKIMI I MARRËVESHJES

Modifikimi i kësaj Marrëveshjeje mund të bëhet vetëm me shkrim dhe me nënshkrim të të dyja Palëve.

NENI 14  
TITUJT

Titujt në këtë MARRËVESHJE janë vendosur vetëm me qëllim të përshtatshmërisë së dokumentit dhe në asnjë mënyrë nuk synojnë të përshkruajnë, interpretojnë, përkufizojnë, ose të kufizojnë fushëveprimin ose qëllimin e kësaj MARRËVESHJEJE apo dispozitave të saj.

SI DËSHMI E KËSAJ, Palët nënshkruhen përmes përfaqësuesve të tyre të autorizuar.